

PROPOZIME TË TË RINJVE

RËNDËSIA E FORCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË PËR PËRBALLUAR KRIZAT RASTI I COVID19

Në kuadrin e projektit

‘Debati universitar për integrimin: Edicioni 2 - Nga fjala tek veprimi’

me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Ky dokument është përgatitur nga:

Ilir Brasha, Universiteti i Tiranës
Zalika Gjomemetaj, Universiteti i Vlorës
Anxhela Kokoshi, Universiteti Luarasi
Marlin Muça, Universiteti i Tiranës

©SCIDEV
Tiranë, Prill 2021

Përmbajtja

Hyrje	4
Përcaktimi i problematikës	5
Rëndësia e arsimit të lartë	5
Përmirësimi i arsimit të lartë	5
Autonomia dhe vendimarrja në universitete	5
Shkenca & Kërkimi	7
Aftësitë digjitale për dhe në arsimin e lartë	7
Shëndeti mendor	8
Rekomandime	8

Hyrje

SCiDEV, bazuar në përvojën e krijuar dhe në interesin e ngjallur nga universitetet, pedagogët dhe studentët gjatë edicionin të parë “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare” (2019-2020), mbështetur nga Fondacioni për Shoqëria e Hapur për Shqipëri, nisi në Shtator 2020 një edicion të dytë të debatit, por duke pasur parasysh kontekstin e ri ku veprojmë jo vetëm me hapjen e negociatave, por edhe me krizën shumë dimensionale social-ekonomike të shkaktuar nga COVID-19 si edhe me nevojën për një rini të angazhuar dhe të motivuar.

Në kuadër të edicionit të dytë të projektit “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitarë-“Nga fjala tek veprimi”, zbatuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) dhe mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), u realizuar programi i ngritjes së kapaciteteve. Gjatë këtij programi, të rinjtë debatues u trajnuan nga ekspertë të fushës me tematike të ndryshme si: ‘Aktivizmin publik dhe politik’, ‘Përdorimi i mjeteve digjitale për aktivizëm’, ‘Pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse: Arsimit të Lartë’. Në këtë seri trajnimesh studentët u njohën nga afër me disa nga proceset vendimmarrëse dhe përfshirjen e studentëve në strukturat e Arsimit të Lartë si strukturat e sigurimit të cilësisë, qeveria studentore, klubet dhe organizatat studentore, Ligji mbi Arsimin e Lartë, etj.

Në vazhdimësi, SCiDEV pilotoi një program “Nga fjala tek veprimi” për mbështetjen e 8 të rinjve debatues për të vënë në jetë nismat e tyre bazuar tek aftësitë e fituara gjatë programit të zhvillimit të kapaciteteve dhe debatit me fokus sektorin e arsimit të lartë dhe në kontekstin e zgjedhjeve parlamentare të 25 prill 2021. Fokusi i fushatës është ndikimi i pandemisë COVID-19 në arsimin e lartë. Të rinjtë, nën mentorimin e ekspertëve, kanë bërë një analizë të thelluar të situatës, kanë hartuar propozime konkrete dhe më pas i kanë parashtruar idetë e tyre kandidatëve për deputet.

Ky dokument paraqet një përmbledhje të analizës kërkimore dhe parashtron propozimet e të rinjve debatues.

Përcaktimi i problematikës

Pandemia e Covid 19 është kriza globale shëndetësore e cila ka shkaktuar dëme të shumta sociale ekonomike, dhe humbje njerëzore të konsiderueshme. Si nevojë e frenimit të përhapjes masive të pandemisë, institucionet arsimore, si ato parauniversitare dhe universitare u mbyllën, duke kaluar mësimdhënien online. Ndonëse kjo ishte zgjidhja më e mirë e mundëshme që rrethanat diktonin, sistemi arsimor ishte i papërgatitur. Sidomos i papërgatitur ishte sistemi universitar, i cili vuante pasojat e shkaktuara nga protesta e studentëve në dhjetor të 2018, tërmeti në nëntor të 2019 dhe tashmë pandemia.

Rëndësia e arsimit të lartë

Arsimi dhe në përgjithësi arsimi i lartë shikohet si një nga faktorët përcaktues në nivelin e përgjithshëm të rritjes së kapitalit human. Duke qenë se rritet kapitali human, ai ka një ndikim të drejtëpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të një vendi duke qenë se ka lidhje të drejtë midis prodhimit të brendshëm bruto me kapitalin human. Arsimi i lartë sjell rritje të kapaciteteve në dije dhe në aftësi. Ai ndihmon në rritjen të kërkimit dhe shkencës, dhe, inovacionit, të cilët janë element shumë të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të një vendi. Vendet që kanë nivele më të larta të kapitalit human të vlerësuar, kanë njëkohësisht edhe të ardhura për frymë më të larta. Një tjetër e dhënë e rëndësishme që i takon rëndësisë së arsimit të lartë lidhet me dhunën ndaj grave. Të dhëna nga INSTAT (2013) tregojnë se gratë me arsim të lartë apo pasuniversitar janë përballë dhunës së formave të ndryshme në nivelin 23.4 pikë përqindje më pak krahasuar me ato me arsimim 8-9 vjeçar. Nga sa më sipër konkludohet se arsimi i lartë dhe sidomos cilësia e tij ka një ndikim relativisht pozitiv si në aspektin ekonomik duke përmirësuar situatën ekonomike, pra duke sjellë një rritje dhe zhvillim më të madh, ashtu edhe duke përmirësuar një sërë aspektesh sociale. Ndaj një sistem i fortë universitar rritë aftësitë e një shoqërie dhe të një vendi për përballimin e krizave.

Përmirësimi i arsimit të lartë

Protesta studentore e dhjetorit 2018, nisi si pakënaqësi ndaj një VKM-je të qeverisë e cila vendosi disa tarifa të larta për provimet e mbarta. Me kalimin e ditëve, kërkesat e studentëve kaluan nga një natyre ekonomike drejt një natyre politike, më konkretisht amendimin e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Protestat studentore treguan qartas që ligji i shumë kontestuar, Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ka nevojë të amendohet për të rritur cilësinë e arsimit të lartë, si parakusht për rritjen e sociale dhe ekonomike, dhe përballimin e krizave.

Autonomia dhe vendimarrja në universitete

Ligji i arsimit të lartë, nën petkun e rritjes së autonomisë së universiteteve, parashikon masa të cilat prekin përfaqësinë e studentëve si dhe Ministria e Arsimit vijon të mbajë shumicën e peshës së vendimarrjes.

Neni 49 shpreh se Bordi i Administrimit luan një rol të rëndësishëm në rregullimin dhe funksionimin financiar dhe administrativ të Universiteteve publike. Në pikën “ë” të këtij neni, parashikohet se ky organ përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që garanton insitucioni nga

veprimtaria e tij. Në pikën “c” të po këtij neni, parashikohet se me propozimin e Senatit Akademik, miratohet bxhjetin vjetor dhe afatmesëm të institucionit dhe mbikqyr zbatimin e tyre. Përbërja e këtij organi ka qenë objekt kritikash nga akademikë dhe aktivistë të shoqërisë civile. Ligji parashikon se Bordi përbëhet nga 7 anëtarë , parashikon cilët janë përfaqësuesit, dhe se nëse institucioni siguron vetë pesëdhjetë përqind ose më shumë të buxhetit afatmesëm, katër prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe tre janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur institucioni siguron vetë më pak se pesëdhjetë për qind të buxhetit afatmesëm, tre prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe katër janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në këtë kontekst autonomia universitare është një parim ku vendimarrja brenda Universitetit zë një rol kyç, ndaj dhe kufizimi i vendimarrjes brenda Bordit të Administrimit në varësi të vetëfinancimit të institucionit, është një masë e cila cënon parimin e autonomisë universitare, duke e lënë institucionin vulnerabël ndaj ndikimit të pushtetit ekzekutiv në universitet.

Në vitin 2018 gjatë lëvizjes studentore, një nga kërkesat e artikuluara ishte rritja e peshës së votës në masën 50%, kërkesë e refuzuar nga qeveria si e pambështetur në asnjë rast homolog në universitetet e huaja. Ky ndryshim në peshën e votës studentore nuk përputhet me masën zgjedhore që kategoria e studentëve zë në universitet, gati 90 %, ndërkohë që personeli akademik (me kohë të plotë) zë rreth 10 % të trupës së përgjithshme zgjedhore. Në Universitetin e Tiranës vota e 1 pedagogu vlen sa vota e 314 studentëve. Rreziku që vjen nga ky reduktim është humbja e interesit të masës studentore kundrejt procesit të zgjedhjeve.

Gjithashtu në këtë aspekt të përfaqësimit të studentëve ligji për arsimin e lartë nuk parashikon përfshirjen e studentëve përfaqësues në Bordin e Administrimit të Universitetit. Gjatë lërvizjes studentore të vitit 2018, një nga 8 kërkesat që iu parashtruan qeverisë, ishte pikërisht përfaqësimi studentor brenda kësaj strukture. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Këshilli i Ministrave nxorri VKM nr. 782 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, në Institucionet publike të Arsimit të Lartë”, që parashikon: “Një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët i paraqesin ministrit tri kandidatura. Ministri përgjegjës për arsimin emëron një prej kandidaturave të paraqitura nga studentët. Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kriterë si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.”

Procesi zgjedhor për anëtarin përfaqësues të studentëve cënon haptazi disa nga parimet themelore të demokracisë në këtë lloj procesesh, kjo pasi vota e studentëve për përfaqësuesit e tyre vlen për të përcaktuar tre kandidatët më të votuar, ku më pas është Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) e cila zgjedh kandidatin fitues ndërmjet tre kandidaturave më të votuara.

Në këtë mënyrë Ministria e Arsimit ruan kuotat e saj në Bordin e Administrimit, duke kamufluar shumicën e saj në Bord nëpërmjet një procesi fars zgjedhjesh studentore. Një tjetër pengesë për përfaqësimin studentor në Bordet e Adinistrimit të universiteteve publike, është pika 10 e VKM, e cila parashikon se: Çdo kandidat për anëtar të bordit duhet të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit, në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike. Kjo pikë krijon një filtër të pamundur për studentët që kanë dëshirë të përfaqësojnë trupën studentore në Bordin e Administrimit. Agjencitë për monitorimin e cilësisë në arsimin e lartë të jenë të pavarura nga ekzekutivi. Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor parashikon njëserëagjencish të cilat do të merren me kontrollin e cilësisë, shpërndarjen e fondeve dhe funksione të tjera, të institucioneve të arsimit të lartë.

Aktualisht, shumica e këtyre agjencive janë nën varësinë e Ministrisë Arsimit, duke krijuar hapësirë ekzekutiviteti tëndikojë nëvlerësimin ekëtyrëagjencice rreth performancës së institucioneve të arsimit të lartë.

Shkenca & Kërkimi

Komisioni Europian vlerëson Shqipërinë në vitin 2020 në lidhje me kapitullin e Shkencës dhe Kërkimit, në fazën fillestare të zhvillimit (1/5), duke qëndruar më dobët në këtë vlerësim krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, përveç Kosovës. Në raport tregohet që Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka rritur vetëdijen mbi mundësitë e Horizon 2020 por që nuk ka bërë diçka tjetër për të rritur pjesëmarrjen në këtë projekt.

Në këtë drejtim shpenzimet e bëra për shkencë dhe kërkim kanë qëndruar poshtë nivelit 1% të PBB-së. Për vitin 2020 shpenzimet e bëra në Shkencë dhe kërkim llogariten që të jenë 227.34 milionë lekë, me një rritje prej 266% nga viti 2019-të, por duke zënë vetëm 0.013545% të shumës së PBB-së. Objektivi i kërkuar nga KE-ja është në masën 1 % e PBB-së. Për vitin 2021 është parashikuar në buxhetin e shtetit që shpenzimet e bëra për studime dhe Projekte (fushë e Kërkimit shkencor) të jenë në masën 0.0594% e PBB-së. (Komisioni Europian).

Serbia, vend i cili është një hap para aderimit në BE në krahasim me Shqipërinë, duke qenë se negociatat janë hapur dhe ka filluar mbyllja e kapitujve, ka shpenzimet për Kërkimin dhe Shkencën në masën e 0.92 % të PBB-së. Prandaj Shqipëria duhet që në këtë fushë të ndjekë shembullin e Serbisë duke rritur gradualisht shpenzimet deri në nivelin 1%. Kjo rritje nuk mund të bëhet e menjëhershme për shkak të situatës së vështirë ekonomike të ardhur si pasojë e Covid 19-ës.

Aftësitë digjitale për dhe në arsimin e lartë

Pandemia e vendosi *Arsimin e Lartë në Shqipëri* përballë një prove e cila diktoi edhe një herë më shumë pikat në të cilat çalonte *Arsimi i Lartë*. Zhvillimi i arsimit në distancë ishte një praktikë e munguar për *Shqipërinë* dhe e pa njohur nga *legjislacioni i brendshëm* i saj. Në ndryshim nga *Gjermania, Suedia, Irlanda, Spanja, etj* të cilat kishin kohë që njihnin dhe aplikonin *mësimdhënjen online*, Shqipëria adoptoi këtë formë të mësimdhënjes gjatë pandemisë. Duke qenë se universitetet vazhdonin të ishin të mbullura në fund të vitit akademik 2020 një pjesë e tyre vendosën që studentet ta zhvillonin provimin e diplomimit ose tezën e përgatitur online. Një praktikë kjo e pa aplikuar më parë, por mbi të gjitha e pa parashikuar nga ligji përkatës. Ndodhur përpara një situatë të tillë a do të njihen diplomat e këtyre studentëve?

Gjatë periudhës Mars-Prill 2020 kur qeveria shpalli domosdoshmërin e mbylljes së universiteteve dhe zhvillimin e mësimin në distancë, të gjithë universitetet në Shqipëri filluan të ndiqnin këtë metodë në javën e 2-3 nga momenti i shpalljes së vendimit. Kjo pasi gjatë përgatitjes për ofrimin e mësimdhënjes online shteti Shqipëtar u ndesh me disa probleme të llojit: *përgatitja e infrastrukturës së IT, zhvillimi i bazës së të dhënave të studentëve, vlerësimi paraprak i mënyrës së përgatitjes së materialeve didaktike*. Edhe pse tashmë ka kaluar plotë një vit që nga mbyllja e universiteteve ajo që vihet re është se arsimit vazhdon të ndeshet me të njëjtat probleme. Aksesueshmëria e studentëve në leksione është e ulët, nuk janë ndërmarrë trajnime për përmirësimin e njohurive dixhitale të stafit petagogjik dhe akoma vazhdojmë në pamundësin e ofrimit të një mësimdhënieje efikase dhe gjithpërfshirëse.

Shëndeti mendor

Duke qenë se fokusi kryesor i qeverive të ndryshme ka qe në ndaj pasojave të Covid-19 tek shëndeti i përgjithshëm fizik, është lënë pas dore shëndeti mendor dhe ai emocional. Masat parandaluese kundër përhapjes së COVID-19, siç është zhvendosja e mësimin në format online ka ndikuar në arsimin e lartë në të gjithë botën. Gjatë kësaj periudhe u ndihe një presion i madh tek studentët i cili u reflektua në përkeqësimin e shëndetit të tyre mendor. U rrit numri i raportimeve të atyre që vuanin nga ankthi, depresioni, i atyre që kishin probleme me gjumin, adiksionet etj. Për t'iu ardhur në ndihmë studentëve që kanë shfaqur probleme gjatë kësaj periudhe *Universiteti i Bremenit në Gjermani*, po përdor podcast si një mënyrë për ty lidhur me studentët. *Universiteti i Aarhus në Danimarkë* inkurajon studentët që të vazhdojnë të mbajnë kontakte e të zhvillojnë takime në platformat elektronike. Ndërsa, universiteti i *Brunel në Londër* ju ofron nëpërmjet rrjeteve sociale, studentëve sesi të kalojnë kohën e tyre të lirë. Mosadresimi i problematikave të shëndetit mendor të studentëve ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë mundësinë për të qenë më eficientë dhe frytdhënës gjatë procesit mësimor.

Rekomandime

Mbi Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Përfaqësimin studentor:

1. Pika dy e nenit 58 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor duhet shfuqizuar për t'i lënë vendit një rregullimi të ri ligjor ku shumica e anëtarëve të Bordeve të Administrimit në universiteteve publike t'i lihet stafit akademik si një garanci shtesë e autonomisë universitare.
2. Eksperienca e universiteteve publike jashtë vendit, tregon se një rritje e peshës së votës studentore në masën 20-25% e bën atë më të përfshirë në veprimtarinë vendimmarrëse të universitetit, por pa e kthyer atë në objektin e një gare populiste, të padenjë për një proces elektoral brenda botës akademike.
3. Shfuqizimi i pikës 6 të VKM nr 782 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit , përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, në Institucionet publike të Arsimit të Lartë" dhe ndryshimi i VKM me shtimin e një pike të re ku të sanksionohet se anëtari përfaqësues i studentëve duhet të zgjidhet ai kandidat me numrin më të lartë të votave.
4. Shfuqizimi i pikës 10 të VKM nr 782 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, në Institucionet publike të Arsimit të Lartë" dhe ndryshimi i VKM me shtimin e një pike ku të sanksionohet se përfaqësuesi i studentëve në Bordin e Administrimit duhet të ketë statusin "Student" duke plotësuar këto kriterë:
 - a) Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake
 - b) Të mos jetë i dënua penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë
 - c) Të ketë mesataren e ponderuar 8 në ciklin e studimeve që ai ndjek, deri në momentin e regjistrimit të kandidatit në institucionet zgjedhore të universitetit.
5. Agjencitë për monitorimin e cilësisë në arsimin e lartë të jenë të pavarura nga ekzekutivi.

Mbi mësimin online

1. Parashikimi në Ligjin për Arsimin e Lartë i mësimin online, si një nga format e mësimdhënjes. Duke ju dhënë kështu mundësinë universiteteve për të përgatitur dhe parashikuar në aktet e tyre të brendshme metodën e ofrimit të mësimin online.

2. Krijimi i një fondi rezerve për studentët që vijnë nga familje në nevojë për të siguruar qasjen e tyre në internet dhe paisjen me mjete dixhitale.
3. Zhvillimi i praktikës, si dhe i punëve në laborator është tepër i rëndësishëm për përvetësimin në mënyrë sa më efikase të aftësive që lidhen me degën e studimit, prandaj është i nevojshëm alternimi i orareve për të bërë të mundur të paktën aplikimin e këtyre orëve fizikisht në laboratorët përkatëse.

Mbi aftësitë digjitale në universitet:

1. Nën drejtimin e ministrisë së arsimit, në bashkëpunim me donatorë apo organizata të cilat punojnë me aftësitë digjitale, duhet të përgatiten programe për zhvillimin e aftësive digjitale të stafit pedagogjik të universiteteve, për të rritur cilësinë e mësimdhënies, dhe efikasitetin në mësimdhënie.
2. Nën drejtimin e ministrisë së arsimit, në bashkëpunim me donatorë apo organizata të cilat punojnë me aftësitë digjitale, duhet të përgatiten programe për zhvillimin e aftësive digjitale të studentëve për të rritur mësimnxënien, dhe efikasitetin në mësimnxënie.
3. Përgatitja e një qasje kombëtare për vendosjen e praktikave në “digital literacy”, për të rritur aftësitë kognitive, dijen, si të studentëve dhe pedagogëve në përdorimin e burimeve digjitale.

Mbi kërkimin shkencor dhe cilësinë e arsimit:

1. Të ndërmeren hapa për implementimin e rekomandimeve të KE në lidhje me:
 - a. Rekomandim i KE, të hartohet një strategji që të mbulojë të gjitha nivelet e arsimit
 - b. Rekomandim i KE-së, të bëhet progres në zhvillimin e Strategjisë së Specializimit Smart
 - c. Rekomandim i KE-së, Të sigurohet pjesëmarrje më e lartë në Horizon 2020
2. Të rriten shpenzimet për kërkim dhe zhvillim me një normë rritjeje prej rreth 54%, për të arritur nivelin 1% të PBB-së për një periudhë kohore prej 10 vitesh. Kjo nuk do të rëndojë buxhetin e shtetit, duke qenë se rritja në vitet fillestare, për shkak të vlerës relativisht të ulët të shpenzimeve, do të jetë në vlera të ulëta.
3. Të bëhet prioritet rritja e shpenzimeve për arsimin e lartë, si një element i rëndësishëm me impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin social dhe ekonomik, duke zbatuar qasje bashkëpunuese me të gjithë aktorët: universitet, politikbërës, sektor privat, dhe shoqëri civile.
4. Rritja e pagave të stafit akademik në universitete si një parakusht për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
5. Kryerja e konsultimeve me studentet sa i përket buxhetit të MASR, AKKSHI.

Mbi shëndetin mendor:

1. Ofrimi i shërbimit të detyruar të psikologut në universitete. Implementimi i qasjen në bashkëpunim me Urdhërin e Psikologut e domosdoshme kjo për të mbrojtur shëndetin mendor të studentëve si gjatë pandemisë dhe pas saj.
2. Krijimi i përmbajtjes audio dhe vizuale (podcasts, video), mbi mënyrat si të menaxhohet stresi, ankthin, e dedikuar për studentët.
3. Krijimi i disa klasave, digjitale dhe fizike, me fokus shëndetin mendor të studentëve, gjatë të cilave studentët pajisen me dije mbi kujdesjen e shëndetit mendor.

